

UDHËZIM
Nr. 10, datë 16.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 24.2.2015, “PËR KRITERET
E PËRGJITHSHME DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN NË PUNË, TË
PERSONELIT TË MËSIMDHËNIES TEORIKE DHE PRAKTIKE NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 26, 54 dhe 60, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neneve 22, pika “d” dhe 23, pika “c”, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 6, datë 24.2.2015, “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punë, të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”, të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

A. Në kreun II, “Procedurat për marrjen në punë të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, germa “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) për shpalljen e vendit vakant, drejtuesi i institucionit i bën propozimin përkatës dhe merr miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

2. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Dokumentet e aplikimit, përcaktuar sipas pikës 4, protokollohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Me aplikantin që shpallet fitues dhe punësohet në atë institucion, lidhet kontratë punë me kohëzgjatje të pacaktuar, nga drejtuesi i institucionit publik të AFP-së, pas marrjes së miratimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

B. Në kreun III, “Komisioni i vlerësimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, germa “c”, ndryshohet:

“c) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

2. Në pikën 3, shprehja “... përfaqësuesi i biznesit, anëtar i bordit”, zëvendësohet me shprehjen “... përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP-së”.

3. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13 Drejtori i institucionit publik të AFP-së, përzgjedh njërin prej dy kandidatëve, me numrin më të madh të pikëve dhe i bën propozimin për emërimin e tij, Drejtorit të Përgjithshëm të SHKP-së”.

C. Në kreun IV, “Procedura për marrjen në punë të mësuesve dhe instruktorëve me kohë të pjesshme në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”, pika 3, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“3. Me kandidatin e renditur në vend të parë, nënshkruhet kontratë pune me afat të caktuar nga drejtuesi i institucionit publik të AFP-së, pas marrjes së miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

Ç. Në kreun V, “Procedura e lirimimit nga puna të personelit të mësimdhënies, teorike dhe praktike, në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Largimi nga detyra bëhet me vendim të drejtorit të shkollës, pas marrjes së miratimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Punës”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla